



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

REPUBLIKA KOSOVO		
MUNICIPALITY OF KLINA OPŠTINA KLINA		
Pranuar me dt. Received on Prilapendim 08, 05, 2024		
Ngjësia org. Unit Organ. Jed.	Numri No.	Vlera Amount Vrednost
02-	052-15531	124

**RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË KONSULTIMIT
PUBLIK PËR DRAFT- STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE
NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT
PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)**

Prill, 2024

HYRJE

Draft -Strategjia Komunale kundër Dhunës në Familje (2024 – 2027), është një prej dokumenteve të rëndësishme të Komunës së Klinës, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti të rëndësishëm për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

Grupi i punës për hartimin e Strategjisë dhe Planit i Veprimit, falënderon veçanërisht institucionet komunale për kontributin e dhënë ku vlerësojnë me prioritet masat për parandalimin e dhunës në familje, në këtë rast falënderojmë drejtoritë përkatëse të komunës së Klinës si dhe Mekanizmin Koordinues kundër Dhunës në Familje.

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në Ligjin Nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 dhe Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.07/2018 për planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.

Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për Komunën e Klinës, mundëson koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare. Qëllimi i vetëm i këtyre përpjekjeve të përbashkëta është të parandalojë dhe luftojë Dhunën në Familje si dhe të ndihmojë zhvillimin adekuat dhe mirëqenien e gjithë shoqërisë sonë.

Parandalimi dhe luftimi i Dhunës në Familje kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet të ndryshme si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj. Tërë këto çështje përmbajnë problematika që duhen zgjidhur përmes proceseve të zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Strukturat vendimmarrëse, së bashku me organizatat joqeveritare, kanë detyrime në zbatim të kësaj strategjie, të cilat rrjedhin nga funksionet specifike dhe roli që luajnë në shoqëri.

Ky dokument synon të japë ndihmesën e saj në arritjen e standardeve më të larta në trajtimin e çështjeve të Dhunës në Familje, si pjesë e përpjekjeve të Komunës së Klinës.

ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT- STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)

Kryetari i Komunës së Klinës në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës (Iniciuesi apo propozuesi i aktit), si dhe Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, duke respektuar UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË, më vendim më numër protokoli 01 Nr. 112-5119, të datës 20.02.2024, kanë caktuar grupin punues në përbërje prej njëmbëdhjetë të anëtarëve:

1. Binak Sylaj, kryesues,
2. Agron Bacaj, anëtarë,
3. Drilon Morina, zyrtarë përgjegjës për të drejtat e njeriut,
4. Vitore Shala, zyrtarë për barazinë gjinore,
5. Astrit Muhaxheri, zyrtarë përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut,
6. Driton Raci, zyrtarë ligjorë,
7. Ahmet Berisha, zyrtarë për punë të kuvendit,
8. Vlora Tafili, zyrtarë për informim,
9. Kristina Lazri, anëtare nga DRKS,
10. Shehrije Millaku, anëtare nga QPS,
11. Adnan Zeneli, zyrtarë përgjegjës për mbrojtje nga diskriminimi.

Grupi punues si dhe Zyrtari Përgjegjës për Konsultim Publik kanë hartuar planin e brendshëm të organizmit të konsultimit, agjendën, identifikimin e palëve, identifikimin e mjeteve të komunikimit, identifikimin e burimeve, mjeteve, formave dhe mënyrave të nevojshme për procesin e konsultimit publik si dhe përmbylljen e procesit me shqyrtimin e kërkesave.

Përveç takimit të drejtpërdrejtë me publikun në ambientin e Sallës së Kuvendit Komunal Klinë, grupi punues ka shfrytëzuar metodën për konsultim me qytetarët prej 30 ditësh në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe në platformën e konsultimit publik në nivel të qeverisë së Republikës së Kosovës:

Komuna Klinë : <https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/?page=2023>

Platformën e konsultimeve publike – Qeveria e Kosovës: <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Materiali për konsultim publik iu është mundësuar të gjithë të interesuarve të merret në formë fizike në **Drejtorinë e Administratës**. Po ashtu, ka qenë i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të **Komunës së Klinës** si dhe në **Platformën e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike**.

Komuna e Klinës e ka të paraparë organizimin e këtij konsultimi publik edhe më
PLANIFIKIMIN E KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2024:

Nr.	Emri i konsultës	Koha e mbajtjes së konsultës
1.	DRAFT- STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026).	MARS – Prill 2024

Shtojca nr. 1 – Tabela e detajuar me numrin e takimeve, pjesëmarrësve dhe numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Takimi i drejtpërdrejtë	08.04.2024	15 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar komente
Platformat elektronike	28.03.2023 11.04.2024	1 pjesëmarrës	1 pjesëmarrës ka dhënë 21 sugjerime-kërkesë nëpërmjet emailit

Dokumentet e lartcekura i janë nënshtruar konsultimit publik në ueb-faqen e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike:

Mirë se vini në platformën e konsultimeve publike - Bëjeni zërin tuaj të dëgjohet



Rreth Platformës

Bazuar në RREGULLOREN PËR STANDARDET MINIMALE PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK nr.05/2016, e cila është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 29 prill 2016, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, obligohet të krijoj dhe mirëmbaj platformën online, të cilin e shfrytëzojnë të gjitha organet publike për të identifikuar hysidartet për zhvillimin e konsultimit me publikun.

Platforma Online, do të sigurojë zbatimin e standardeve minimale për konsultime publike sipas Rregullores nr. 05/2016. Kjo platformë do të ofroj mundësinë që të gjitha palët relevante të jenë të ftuara dhe të përfshira në procesin e konsultimit publik për asmat legislative dhe procesin e vendimmarrjes dhe të ndaliko



Platforma gjithëpërfshirëse për konsultimet me publikun



Konsultimet e fundit

Njoftim për konsultim publik lidhur me DRAFT - STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2026)

Njoftim për konsultim publik lidhur me DRAFT - STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2026) ... Me shume

PROJEKTILIGJI PËR BANIM SOCIAL DHE TË PËRBALLUESHËM

REPUBLIKA E KOSOVES
QEVERIA - ZYRA E KRYEMINISTRI
ZYRA PER QEVERISJE TE MIRE

Shqip | English | Serbisht

Ballina Lajmet Rreth platformes Institutional Kerkja komune Takimet konsultative Dokumentet Statistika Kontaktet Rreth Regjistrimi

22.04.2024

Njoftim për konsultim publik lidhur me DRAFT- STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2026)

Njoftim për konsultim publik lidhur me DRAFT - STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2026)

Data e fillimit: 28.03.2024

Data e përfundimit: 11.04.2024

Dokumentacioni

DRAFT-STRATEGJIA-DHE-PLANI I VEPRIMIT PËR DHUNE NË FAMILJE 2024 2027.docx

Dokumentacioni shtesë

Emri i personit kontaktues
Bilal Sylla

Email i personit kontaktues
bilal.sylla@rk-gov.net

Të gjitha kërkesat e parashtuara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 2 të këtij raporti.

Shtojca nr. 2 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara:

Temat e Konsultimit	Numri i kërkesave / Sugjerimet / Komentet	Numri i personave që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Statusi i kërkesës / sugjerimi (të pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Statusi i kërkesës / sugjerimi që nuk është pranuar
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Takimi i drejtpërdrejtë 2 Komente	2 pjesëmarrës kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	1 koment i pranuar 1 koment Pjesërisht i pranuar	0 komente të refuzuar
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Platformat elektronike 21 kërkesa	1 pjesëmarrës kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	19 kërkesa të pranuar	3 kërkesa të refuzuara
Gjithsej	23 kërkesa	3 pjesëmarrës kanë	19 kërkesa të pranuar,	3 kërkesa të refuzuara

		parashtruar kërkesa	1 pjesërisht të pranuara	
--	--	--------------------------------	-------------------------------------	--

Shtojca nr. 3 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara:

Temat e konsultimit Publik	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Koment: A është DRAFT - STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) në përputhje me STRATEGJIA KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE?	Vlora Tafili, Klinë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të komentit ka theksuar se kjo strategji është hartuar duke pasur për bazë Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Propozim: A mund të përfshije si mundësi kjo strategji të sigurojë strehim të përhershëm dhe më afatgjatë nga Komuna?	Nazife Qallapeku, Klinë.	Pjesërisht Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të propozimit ka pranuar pjesërisht kërkesën për shkak që strehimi i përhershëm ka kosto të lartë financiare. Pasi që numri i viktimave të dhunës në familje çdo vit është në rritje si dhe Komuna e Klinës nuk e ka të ndërtuar strehimoren e veçantë për këto raste. Komuna e Klinës në bazë të kërkesave subvencionon shtëpinë e sigurt në Pejë për çdo vit. Si dhe në shumicën e rasteve paguan edhe qira për strehim. Gjithsesi që në këtë draft janë parapa këto shuma.
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE	Koment: Të fshihet fjala “Parandalim”. Tek: - Ndarja e përvojave të suksesshme të grave në pozita udhëheqëse gjatë takimeve me gratë dhe komunitetin Parandalimi	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të fjalisë ka hequr fjalën.

NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)				
DRAFT- STRATEGJI A KOMUNAL E PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Koment: Ky plan i veprimit do të duhej të ishte më gjithëpërfshirës - dhuna në familje ka shtrirje më të gjerë dhe nuk është e reduktuar vetëm në dhunën ndaj grave (siç është në masë të madhe në këtë plan veprimi).	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritar e (OJQ).	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka dhënë arsyetimin se ky plan i veprimit në masë të madhe ka shtrirje për mbrojtjen nga dhuna ndaj grave duke pas parasysh statistikën e fundit dhe ngjarjet që kanë ndodhur në vendin tonë.
DRAFT- STRATEGJI A KOMUNAL E PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT	Koment: Në këtë plan të veprimit mungojnë treguesit ku pasqyrojnë vlerën e gjendjes aktuale/vlerën bazë (të shprehur në përqindje apo në numra) dhe se si parashihet të përmirësohet ajo ndër vite – synimet	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritar e (OJQ).	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues ka refuzuar kërkesën sepse nuk kemi të dhëna të sakta të rasteve të dhunës. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë ofrohen të dhëna vetëm në kuadër të regjionit. https://md.rks-

PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	për vitet e ardhshme.			gov.net/page.aspx?id=1,184
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Kërkesë: Është buxhet i vogël për rëndësinë që ka kjo kategori dhe realizimin praktikë të tij – rekomandojmë të shihen mundësitë për rritje fondesh.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën për rritje fondesh.
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE	Koment: Të përmirësohet: sipas vlerësimit të fundit të popullsisë për vitin 2022, Komuna e Klinës ka 40,164 banorë.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka refuzuar kërkesën, pasi që Regjistrimi Zyrtar i Popullsisë në vitin 2011, thotë që Komuna e Klinës ka një popullsi prej 38.496 banorë

PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)				rezident, prej te cilëve 37.216 janë shqiptar, 98 serb, 3 turq, 20 boshnjak, 78 romë, 85 ashkalinj, 934 egjiptian dhe 23 te tjerë. https://kk.rks-gov.net/kline/qyteti/n-umri-i-banoreve/. Ndërsa, ky i vitit 2022 është vetëm vlerësim të cilin ASK e realizon çdo vit.
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Kërkesë: Të përfshihen në këtë kategori: - Bashkëpunimi me radio lokale për të transmetuar mesazhe ndërgjegjëse; - Përdorimi i platformave/mediave sociale për të arritur një audiencë më të gjerë; - Organizimi i një seri video-klipesh të shkurtra ku të mbijetuarat ndajnë historitë e tyre dhe theksojnë rëndësinë e luftimit të stereotipeve gjinore.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka shtuar këto aktivitete në Draft-Planin e Veprimit.
DRAFT-STRATEGJIA	Koment: Duhet të specifikohet numri i fushatave/kampanja	Democracy Plus (D+)	Pranohet	Përgjigja:

KOMUNAL E PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	ve që planifikohen të organizohen për të zbatimin e suksesshëm të këtij plani, e që pastaj do të mundësoj monitorimin dhe vlerësimin e progresit.	Organizatë joqeveritar e (OJQ).		Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka specifikuar numrin e takimeve dhe kampanjave në Draft- Planin e Veprimit.
DRAFT- STRATEGJI A KOMUNAL E PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE. (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Koment: Për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të aplikojnë njohuritë e tyre në mënyrë efektive, të shtohen në këtë kategori: Përfshirja e skenarëve praktikë dhe studimeve të rasteve gjatë sesioneve të trajnimit; Ushtrime të rolit ku pjesëmarrësit praktikojnë reagimin ndaj situatave të dhunës në familje.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritar e (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka shtuar këto aktivitete në Draft-Planin e Veprimit.

DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Koment: Të shtohet në këtë kategori: Përfshirjen e grave udhëheqëse lokale ose gratë model në komunitet si folës të ftuar gjatë këtyre takimeve. Shembull konkret: të ftuar do të jenë gra sipërmarrëse të suksesshme ose një avokate e specializuar për çështje familjare për të ndarë përvojat dhe njohuritë e tyre.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritar e (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka shtuar këto aktivitete në Draft-Planin e Veprimit.
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE	Koment: Merrni parasysh përfshirjen e seminareve ose sesioneve për fuqizimin ligjor për të edukuar gratë dhe të rinjtë rreth të drejtave të tyre ligjore dhe rrugëve për të kërkuar ndihmë në rastet e dhunës me bazë gjinore.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritar e (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka shtuar këto aktivitete në Draft-Planin e Veprimit.

(2024 – 2026)				
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Kërkesë: Të specifikohet numri i takimeve që planifikohen të mbahen.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka specifikuar numrin e takimeve dhe kampanjave në Draft-Planin e Veprimit.
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA	Sugjerim: Për të pasur më shumë ndikim, merrni parasysh organizimin e seminareve interaktive ose ekspozitave të artit krahas leksioneve. Për shembull: organizoni një ekspozitë arti ku artistë të rinj krijojnë pjesë që përshkruajnë:	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka shtuar këto aktivitete në Draft-Planin e Veprimit.

DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	- ndikimin e dhunës në familje; - promovojnë barazinë gjinore.			
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Rekomandim: Sa takime planifikohet të mbahen? Rekomandojmë: Organizimin e një paneli me gra të suksesshme që ndajnë përvojën e tyre për të arritur në pozitat vendimmarrëse.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka specifikuar numrin e takimeve dhe kampanjave në Draft-Planin e Veprimit.
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR	Rekomandim: Të krijohen materiale informative digjitale: video, infografika, artikuj online, që mund të ndahen me nxënësit dhe mësimdhënësit përmes platformave/rrejteteve sociale.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka shtuar këto aktivitete në Draft-Planin e Veprimit.

MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)				
DRAFT- STRATEGJI A KOMUNAL E PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026).	Rekomandim: Planifikimi i aktiviteteve duhet të jetë më i diversifikuar. Rekomandojmë që në këtë kategori të përfshihen: sesione të diskutimit në klasë, prezantime nga ekspertë të fushës, dhe trajnime për mësimdhënësit për të trajtuar temën në mënyrë më të plotësuar dhe efektive.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritar e (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka shtuar këto aktivitete në Draft-Planin e Veprimit.
DRAFT- STRATEGJI A KOMUNAL E PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I	Koment: Të vendoset një Listë me shkurtesa në fillim të dokumentit, ku tregohet edhe emri i plotë i institucioneve.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritar e (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe i ka shtuar Draft-Planin e Veprimit Listën me shkurtesa në fillim të dokumentit, ku tregohet edhe emri i plotë i institucioneve.

VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)				
DRAFT- STRATEGJI A KOMUNAL E PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Koment: “Deri në vitin 2026 numri i nxënësve që braktisin shkollën prej DH.F ulët nga 8 % në 5%”, a i keni këto të dhëna 8% - si bazë?	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritar e (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën. Konstatohet ka qenë gabim i lëshuar teknik, andaj përmirësohet duke theksuar se në bashkëpunim me Ekipin për Parandalim dhe Reagim të Braktisjes në Shkolla dhe atij të nivelit komunal të angazhohen që niveli i braktisjes së shkollimit mbi bazën e dhunës në familje të mbetet 0.
DRAFT- STRATEGJI A KOMUNAL E PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 –	Rekomandim: Hulumtimet mund të përfshijnë intervista me nxënësit, prindërit, dhe stafin shkollor për të identifikuar shkaqet specifike dhe për të përmirësuar	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritar e (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe ka përfshirë këto lloje të hulumtimeve në Draft- Planin e Veprimit.

2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	strategjitë e intervenimit. Pas kryerjes së hulumtimeve, është e rëndësishme që rezultatet e tyre të përdoren për të planifikuar veprimet e ardhshme për të zvogëluar numrin e nxënësve që braktisin shkollën për shkak të dhunës në familje. Planifikimi i veprimeve duhet të bazohet në analizën e rezultateve dhe të përfshijë masa konkrete për të adresuar shkaqet e identifikuara. Për shembull, nëse hulumtimet identifikojnë mungesën e mbështetjes për nxënësit e prekur nga dhuna në familje, mund të propozohen programe mbështetëse në shkolla ose trajnime për stafin shkollor për të menaxhuar këtë problematikë.			
---	---	--	--	--

DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Sugjerim: Një shembull konkret mund të jetë krijimi i një qendre të specializuar për të kryer këto detyra, ku viktimat mund të marrin mbështetje të nevojshme dhe udhëzime për të ndërmarrë hapat e mëtejshëm drejt punësimit.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën me arsyetimin se ekziston Qendra për Angazhim të Komunitetit (QAK), ku organizohen aktivitete e ngjarje nga Organizata të ndryshme me ekspert të fushave të shumta. Andaj do të ndërmirën hapa për mbështetje të nevojshme dhe udhëzime për të drejt punësimit.
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE	Koment: Për të përmirësuar këtë aspekt, mund të organizohen seminare ose trajnime të specializuara për viktimat e dhunës në familje për t'u përgatitur për tregun e punës.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe ka shtuar organizimin e seminareve ose trajnime të specializuara për viktimat e dhunës në familje për t'u përgatitur për tregun e punës.

(2024 – 2026)				
DRAFT-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)	Kërkesë: Të parashihet ndarja në vite.	Democracy Plus (D+) Organizatë joqeveritare (OJQ).	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën dhe ka ndarë shumën nëpër vite.

Bashkangjitur gjeni edhe shtojcën e draft dokumentit të STRATEGJINË KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026), të përcjellë me të gjitha komentet nga Organizata Democracy Plus (D+).

<https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/>

Aktivitetet	Veprimet	Buxheti			Total	Komuna Donatorët	Afati i zbatimit	Institucioni Përgjegjës dhe mbështetës	Indikatori i suksesit
		2024	2025	2026					
FUSHA E VEPRIMIT- A: . ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE									
Deri ne vitin 2026, strategjia lokale synon të ndryshojë qasjen në familje dhe shoqëri për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje.									
1.Eliminimi I stereotipave gjinore për luftimin e dhunës në familje	Fushata <u>vetëdijësuese</u> dhe kampanja informuese <u>mediatike</u> për publikun e <u>gjerë</u> në komunën e Klinës për DH.F	100 €	100€	100€	300€		2024-2026	Njësia për të Drejtat e Njeriut, QPS Media lokale Komuna OJQ-të	Prej rreth 96 <u>450</u> banorëve , rreth 35% e tyre kanë marrë mesazhin dhe janë bërë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuere
	Trajnimet për Barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve vendore	S'ka kosto	S'ka kosto	S'ka kosto					
2. Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe të rinjve , institucioneve dhe bizneseve për pasojat e dhunës në	<u>Takime</u> me gra dhe vajza që fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në DH.F. Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe	100€	100€	100€	300€		2024-2026	Komuna + Donatorët	

Democracy Plus April 10, 2024
Edheë buxhet i vogël për rimëkëmbje që ka kjo kategori dhe realizimin praktikë të tij - rekomandojmë të shikohet mundësitë për rrjetë fondesh.

Democracy Plus
Të përmirësohet sipas vlerësimit të fundit të popullsisë për vitin 2022, Komuna e Klinës ka 40,164 banorë.

Democracy Plus
Të përfshihen në këtë kategori:
→ Bashkëpunim me radio lokale për të transmetuar mesazhe ndërgjegjësuere.
→ Përdorim i platformave medive sociale për të arritur një audiencë më të gjerë.
→ Organizimi i një seri video-klipeve të shkurtra ku të mbajeturat ndajnë historitë e tyre dhe theksojnë rëndësinë e luftimit të dhunës gjinore.

Democracy Plus
Duhet të specifikohet numri i fushatave kampanjave që planifikohen të organizohen për të zbatimin e suksesshëm të këtij plani, e që pastaj do të mundësojë monitorimin dhe vlerësimin e progresit.

Democracy Plus
Për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të aplikojnë njohuritë e tyre në mënyrë efektive, të shohet në këtë kategori:
→ Përfshirja e shërbësve praktikë dhe studiuesve të rasteve gjatë sesioneve të trajnimit;
→ Udhëzime të robit ku pjesëmarrësit praktikojnë reagimin ndaj situatave të dhunës në familje.


Democracy Plus
Të shohet në këtë kategori:
Përfshirjen e grave udhëheqëse lokale ose gratë model në komunitet si fjalës të ftuar gjatë këtyre takimeve. Shembull konkret: të ftuar do të jenë gra sipërmarrëse të suksesshme ose që avokatet e specializuar për çështje familjare për të ndarë përvojat dhe njohuritë e tyre.

Procesit të organizimit të konsultimeve publike për DRAFT- STRATEGJINË KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026), i kanë kontribuar me pjesëmarrje 15 persona si dhe një Organizatë joqeveritare (OJQ).

Shtojca Nr. 3 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë:

Femra	12
Meshkuj	3
Total:	15

Shtojca Nr. 4 – Tabela e trajtimit të kërkesave/komenteve, shprehur në grafikon :



Kryesuesi i Grupit Punues,

Binak Sylaj



Klinë, 08 .05.2024